



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 51, datë 31.05.2017

PËR

“PËR ANËTARËSIMIN E BASHKISË SË TIRANËS NË SHOQATËN “ICLEI: LOCAL GOVERNMENTS FOR SUSTAINABILITY”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/ 1.1, shkronja (b), pika 1/ 1.5, shkronja (c) pika 1/ 1.6 dhe pika 2, nenit 26, nenit 54, shkronja (d), nenit 55, pikat 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 4, të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 29.12.2016 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar) me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë anëtarësimin e Bashkisë së Tiranës, si anëtare në shoqatën “ICLEI: Local Governments for Sustainability”.
2. Kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij, të përfaqësojë Bashkinë e Tiranës në organet përfaqësuese të shoqatës, si dhe të kryejë çdo veprim të nevojshëm që vjen si rrjedhojë e anëtarësimit në këtë shoqatë.
3. Efektet financiare për pagesën e kuotës vjetore të anëtarësisë, do të përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Tiranë dhe kryhet sipas parashikimeve të përcaktuara në statutin dhe aktet e shoqatës, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
4. Kuota e anëtarësisë për vitin 2017, në shumën prej 650 (gjashtëqindpesëdhjetë) euro, përballohet nga fondi i aparatit të Bashkisë në programin e Administratës Vendore për kuota anëtarësie.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit Europian për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI